



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assambly Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KOMITETI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e komitetit për **Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, e treta** me radhë, e mbajtur me datë **21.06.2024 (e premte)**, me fillim në ora **09:15**

Mbledhjen e kryesoi kryesuesja e komitetit, **znj. Almedina Jaha**. Të gjithë anëtarët e komitetit ishin të pranishëm në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Të ndryshme;**
- 3. Vizitë OJQ-ve të Komunës së Rahovecit: Hareja, Hendikos, Opfakos dhe SHL-Kosova.**

Kryesuesja: Mirëmëngjesi! Përshëndetje për të gjithë! Jemi mbledhur sot në takimin e tretë të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, vazhdojmë me leximin e rendit të ditës. Atëherë, rendin e ditës si të tillë e vendosim në votim! Kush është “pro”?... Unanimisht aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja: Atëherë, nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “pro”?... Unanimisht aprovohet procesverbali, pika e parë e rendit të ditës.

2. Të ndryshme;

Kryesuesja: Atëherë, sot si pikë e dytë është pika të ndryshme apo eventualet. Nëse dikush ka diçka për të thënë?...

Altina Mezini: Përshëndetje për të gjithë! Nëse ka mundësi të jem në dijeni se çka ka ndodhur me vizitën e planifikuar në shkollën “Isa Boletini”?...

Selman Shtavica: Përshëndetje! Do të ishte mirë që vizitave t’i shtohet edhe vizita në QPS!

Atdhe Rama: Do t’i realizojmë vizitat e cekura sot. Gjatë mbledhjeve të radhës mund t’i vizitojmë qendrat dhe institucionet tjera.

Selman Shtavica: Atëherë, meqë sot e kemi në plan të viziojmë Hendikos-in, mund ta vizitojmë edhe Kryqin e Kuq, objekti i të cilit është në të njëjtin vend me Hendikos-in.

Atdhe Rama: Këtu besoj pajtohem të gjithë, mund të shkojmë edhe atje. Faleminderit Selman!

3. Vizitë OJQ-ve të Komunës së Rahovecit: Hareja, Hendikos, Opfakos dhe SHL-Kosova.

Kryesuesja: Faleminderit Atdhe! A ka dikush diçka për fund? Nëse jo, atëherë takimi për sot përfundoi. Ju përshëndes dhe shihemi në takimin e radhës. Ne vazhdojmë t’i realizojmë takimet e planifikuara.

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi

Kryesuesja e komitetit;


Almedina Jaha

